

26 shtator 2022

Ftesë

Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG), në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë CCIT, ju fton të merrni pjesë në seminarin:

“Seminari për bizneset për të rritur ndërgjegjësimin mbi procedurat e falimentimit bazuar në kuadrin e ri ligjor për të nxitur ristrukturimin kur nevojitet”


Seminari është i organizuar në kuadër të Projektit “Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja nga Biznesi, Faza II”, mbështetur nga Ambasada Zvicerane – Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), dhe do të mbahet në datat 19 dhe 20 tetor, 2022, në orën 11:00 am, tek salla e konferencave të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë (*Rruga e Kavajës 24, Tiranë*) sikur se edhe online nëpërmjet përdorimit të platformës webex.

(Ju bëjmë me dije se detajet për lidhjen në platformë do t’ju dërgohen në email-in tuaj një ditë përpara aktivitetit dhe pasi të keni konfirmuar pjesëmarrjen tuaj).

Seminari i cili do të zhvillohet në harkun kohor prej dy ditësh ka për qëllim të ndërgjegjësojë përfaqësuesit e bizneseve në lidhje me procedurat e falimentimit dhe praktikën jashtëgjyqësore të saj dhe do të sjelli në tryezë raste konkrete të falimentimit të shoqëruara nga procedura përkatëse.

Prezantuesi:

Olsi Çoku është një avokat shumë i arsimuar dhe i orientuar drejt detajeve me përvojë të gjerë në industrinë e shërbimeve të konsulencës nga faza e fillimit deri në pjekurinë e projekteve. Ai është një avokat i njohur me përvojë 12 vjeçare në menaxhim të projekteve të ciklit të plotë, financë dhe bankë, energji, licensim, çështje lejesh, koncesione/PPP, punësim, qeverisje korporative, ngritje kapacitetesh të infrastrukturave të mëdha, organizim dhe funksionim të qeverisjes vendore, etj. Si rezultat i ekspertizës së tij, Z. Çoku është mbajtur vazhdimisht si këshilltar ligjor nga qeveria shqiptare, kompani vendase dhe të huaja dhe organizata ndërkombëtare. Në vitet e fundit, ai ka kontribuar dukshëm në ndërtimin e institucioneve të tregut shqiptar të gazit dhe reformave të ndryshme ligjore dhe strategjike në vend. Z. Çoku ka një diplomë Master Ligjor në të Drejtën e Biznesit dhe një çertifikatë të së Drejtës së Biznesit Evropian nga Universiteti Lund në Suedi dhe është anëtar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë dhe grupit të nivelit të lartë të ekspertëve konsultues për reformat ligjore të krijuar nga Ministri i Drejtësisë.



Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj fizike apo virtuale në adresën e email-it: albana_laknori@cci.al ose në numrin e celularit 0693410000 deri më datën 15 tetor 2022. Gjithashtu, ju lutemi të na bëni me dije nëse kolegët tuaj dëshirojnë të marrin pjesë fizikisht apo virtualisht në këtë seminar duke na dërguar kontaktet email të tyre me qëllim që të dërgojmë të dhënat për lidhjen online tek secili pjesëmarrës.

Për më tepër informacion në lidhje me aktivitetin, ju lutem gjeni bashkëlidhur axhendat për secilën ditë.

Për pjesëmarrësit virtual, në rast se do keni pyetje për panelistët, ju mund të shkruani në seksionin e komenteve të platformës gjatë eventit.

Ju mirëpresim dhe ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Z. Igor Matijevic

Menaxher Rajonal për Programin
Korporata Financiare Ndërkombëtare
Grupi i Bankës Botërore

Z. Nikolin Jaka

President

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë